



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:256807

Datë: 15.07.2020

Numri i dokumentit: 01024278

P.nr.1009/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ahmet Rexhaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lindmire Begolli, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M K nga fshati V K.Pejë , për shkak të veprës penale: "Legalizim i përmbajtjes së rreme" nga neni 395 par.2 e lidhur me par.1 te KPRK- se duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II.Nr.1823/19 të datës 30.10.2019 , pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 07.07.2020, në prezencë të prokurorit të shtetit Sadije Muriqi , të akuzuarit M K , mori dhe shpalli si dhe me datë 08.07.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M K I lindur me ... në P ku tani banon ne fsh.V K.P , I biri I S-it , nënës Z , e gjinisë T , ka te kryer shkollën fillore , me prof. bujk , I gjendjes se dobët ekonomike , me nr.perso.... , shqiptar, shtetas I Republikës se Kosovës , gjendet ne liri .

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I akuzuari M K

Me parë e në vazhdimësi gjer me datën 18.06.2019 , me dije përdor dokumentin edhe pse e di që është i rremë , dhe atë karrocerinë e automjetit të të markës O F, me nr. të targave ..., ngjyrë e zezë, viti i prodhimit 1993 , me nr. të karrocerisë ... , ashtu që ka manipuluar numrin e karrocerisë në veturën e lartëcekur ku VIN-i është lyer me ngjyrë, e këtë me qëllim të përdorimit të automjetit me nr. të karrocerisë si të vërtetë edhe pse e ka ditur se numri i sasisë është i rremë,

-Me çka ka kryer vepër penale, "Legalizim i përmbajtjes së rreme " nga neni 395 par 5 lidhur me par.1 te KPRK-së

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7,41,42,43,46,49,50,51,52,73, të KPRK-së, neni 395 par.5 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPK-së, të akuzuarit M K iu shqiptohet :

I akuzuari M K - DËNIM ME KUSHT

I shqipton dënim me burgim me kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj ,mirëpo ky dënim nuk do te ekzekutohet ne qoftëse i pandehuri ne afat prej 1(një) viti nuk kryen vepër tjetër penale .

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore ta paguaj shumen prej 30 (tridhjetë) euro , paushalli gjyqësore 20 (njëzetë) euro në emër të programin për kompensimin e viktimave të krimit ne shume prej 30 (tridhjetë euro), në afat prej 15 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të përgjithshme ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1823/19 të datës 30.10.2019, ndaj të akuzuarit M K nga fsh.V K.P, , për shkak të veprës penale “Legalizim i përmbajtjes së rreme ” nga neni 395 par 5 lidhur me par.1 te KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 07.07.2020, Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores së shtetit PP/II.nr.1823/19 të datës 30.10.2019, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar të gjitha benefitet e pranimin të fajësisë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet me aktakuzë. Është e vërtetë që e kam poseduar automjetin O F me targa ..., me shënim si ne dispozitiv të aktakuzës i cili automjet me është sekuestruar me aktvendim të kësaj gjykate për shkak se ne homologimit te automjeteve ka rezultuar se numri i karaseris është i rremë , unë atë automjet siq me kujtohet dhe siq kam deklaruar ne polici e kam blerë në treg e automjeteve e kam regjistruar radhazi 3-4 vite siq me kujtohet sipas lejes se qarkullimit pasi qe ka rezultuar se nuk është ne rregull dokumentacioni i veturës , unë e pranoj fajësinë dhe kërkoj falje , shprehi keqardhje para gjykatës dhe premtoj qe nuk do ti përsëris veprime te tilla apo te ngjashme ne te ardhmen.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, i propozon Gjykatës ta pranoj fajësinë nga ana e të akuzuarit dhe i njëjti të çmohet si pranim i vullnetshëm dhe i sinqertë me rastin e marrjes së vendimit i propozoj Gjykatës që

pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ta merret si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Raporti informues me nr. te rastit 2019-DI-21 i dt.18.06.2019 , Kërkesa për sekuestrim të përkohshëm, PPN.II.nr 530/2019 dt.18.06.2019, Urdhëri , Gjykata Themelore në Pejë , nr. UGJK. 77/19 për Sekuestrim të përkohshëm të sendeve dt.18.06.2019, Urdhëri për Eksoertizë të numrit të Karrocerisë drejtuar Agjencionit Kosovar per forenzikë në Prishtinë dt.16.07.2019, Kallzimi Penal nr.2019-DA-21 , dt.16.07.2019, Raporti informues dt.18.06.2019, 2019-DI-21, Raporti i oficerit Shaban Zeneli , dt.17.06.2019, Procesverbali i marrjes në pyetje në polici të të dyshuarit M K dt.13.06.2019, Formulari i konfiskimit të veturës, librezës së qarkullimit dhe te qelsave të veturës , dt.14.06.2019, Email komunikimi , dt.15.06.2019, Njoftimi i Qendrës së Automjeteve të Kosovës , për mos lëshim të Urdhëresës për ri-shtypje të VINI-it, dt.17.05.2019 prej 8 faqesh, Tetë(8) foto të veturës së sekuestruar, Libreza e qarkullimit, Plotësimi i Kallzimit Penal , dt.03.09.2019, nr.2019-DI-21, Raporti i Ekspertizës së Agjencionit të Kosovës për Forenzikë, dt.15.08.2019, nr.AKF/2019-1923/2019-1705, Kërkesën per urdhër të përkohshëm te sigurisë te sendeve te sekuestruara përkohësisht, dt.16.08.2019, urdhëri për masë te përkohshëm te sigurisë te veturës , Gjykata Themelore në Pejë , dt.19.08.2019, UGJK nr.111/19, Procesverbali mbi marrjen në pyetje te te pandehurit ne prokurori me dt.16.10.2019, gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të përshkuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtores.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e ka pranuar fajësinë qysh në fillim, pati sjellje korrekte në shqyrtim fillestar, është penduar, për gjykatën nuk ka të dhëna se i njëjti ka ra ndesh me ligjin më parë, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk ka gjete asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të saj dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të

shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarve në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KRPK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, e obligoi të akuzuarin në paguarjen e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që të paguaj shpenzimet e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

**NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1009/19. Dt.08.07.2020**

Sekretare juridike
Lindmire Begolli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ahmet Rexhaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.